

STATUT

SHOQERIA KONCESIONARE

VLORA HARBOR CONSTRUCTION AND MAINTANANCE sh.p.k

Tirane, 28.05. 2022



PERKUFIZIME:

Ne kete Statut:

- (i) "Statuti" ka kuptimin e Statutit te Shoqerise
- (ii) Koncesionari ka kuptimin e Bashkimit te operatoreve ekonomike Agbes Konstruksion Shpk, Besta Shpk, Premium Construction & Maintenance Shpk, ITE.Grup Shpk, Arkon Studio Shpk
- (iii) Kontrata ka kuptimin e Kontrates se Koncesionit nr. 554 Rep. Nr 203 Kol date 29.04.2022 e lidhur midis Ministrise se Transportit dhe Infrastruktures 'Autoriteti Kontraktues' dhe Konkensionarit ne baze te parashikimeve te se ciles themelohet kjo shoqeri koncesionare.
- (iv) QKB- Qendra Kombetare e Biznesit ne Shqiperi.

KREU I

Themelimi, Emri, Objekti, Kohezgjatja, Selia

Neni 1

Data e themelimit, Emri dhe Themeluesit

1.1 Sot ne daten 28.05.2022 ne, themeluesit, kemi krijuar nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me emrin Shoqeria Koncesionare "Vlora Harbor Construction and Maintenance " sh.p.k

1.2 Themeluesit e shoqerise jane:

- i. **Shoqëria "Shoqëria AGBES KONSTRUKSION shpk**, regjistruar si person juridik në QKB (Qendra kombëtare e bizneseve) me numër unik identifikimi të subjektit NUIS K32807432W, me adresë Sheq I Madh, përfaqësuar nga Administratori z. **Arben Goga**, atësia Pandi, amësia Jana, shtetas Shqiptar, lindur në Fier dhe banues në Tiranë, me adresë Bilal Sina; Nd. 4; H. 1; Ap. 14; Farkë; Selitë; 1045; Tiranë, lindur më 23/11/1968, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Letërnjoftim ID nr. 034871169 dhe nr. personal G81123041J, dhe nga Administratori **Z. Bashkim Ramaj**, atesia Lamce, amesia Hyrie, shtetas Shqiptar, lindur ne Fier dhe banues ne Tirane, lindur me 02.01.1965 madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Letërnjoftim ID nr035161302 dhe me nr personal G50101222P.
- ii. **Shoqëria "BESTA" sh.p.k.**, shoqëri e regjistruar në QKB në datë 15.09.1992, me numër regjistrimi J62903182B, me seli në Berat ne adresën: Ura Vajgurore, Njësia Administrative Poshnje, Ndërtesë dy katëshe, kati i dytë, Zona kadastrale 3032, Pasuria Nr.326/20, Berat, përfaqësuar nga **Znj. Drita Azizi**, shtetas Shqiptar, lindur nëVodez, Berat më 10.01.1986 mbajtës i Letërnjoftimit ID me nr. Personal I65110001Q madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar.
- iii. **Shoqëria "PREMIUM CONSTRUCTION & MAINTENANCE"** sh.p.k shoqëri e regjistruar në QKB ne date 16.6.2021 me M11816005V, me seli në Tiranë, Rruga 365, Pallati Nr.8, Kati i 8, Apartamenti B, Tiranë, përfaqësuar nga **z Hektor Agalliu** shtetas Shqiptar, lindur nëTerpan më 27.01.1957 mbajtës i Letërnjoftimit ID me nr. Personal F70127128J madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar.
- iv. **Shoqëria "ITE. GRUP" sh.p.k** shoqëri e regjistruar në QKB ne date 22.01.2001 me NIPT K11323001H, me seli në Tiranë, Rruga Dytësore Autostrada Tirane - Durres, Km 5, Tiranë, përfaqësuar nga administratorit **z Sokol Zotkaj**, shtetas Shqiptar, lindur në Tirane

më 07.05.1956 , mbajtës i Letërnjoftimit ID me nr. Personal F60507103W, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

- v. **Shoqëria "ARKONSTUDIO" sh.p.k** shoqëri e regjistruar në QKB ne date 19.08.2014 me NIPT L42019004I, me seli në Tiranë, rruga "Mihal Duri", Objekti Nr. 33, Tiranë përfaqësuar nga z Nasjel Cico shtetas Shqiptar, lindur në Korce më 30.01.1987 mbajtës i Letërnjoftimit ID me nr. Personal I70130120E , madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

Neni 2

Objekti i Veprimtarise

Shoqeria Koncesionare "Vlora Harbor Construction and Maintanace " sh.p.k eshte subjekt i themeluar per qellim te veçante dhe ka per objekt te veprimtarise zbatimin dhe permbushjen e kushteve te Kontrates se Konkensionit nr. 554 Rep. NR 203 Kol date 29.04.2022 te lidhur midis Ministrise se Transportit dhe Infrastruktures 'Autoriteti Kontraktues' dhe Konkensionarit, me objekt Projektimi ndertimi dhe mirembajtaj e Portit te Integruar ne Triport Vlore , si dhe kryerjen e cdo aktiviteti tjetër te nevojshem, ndihmes apo plotesues ne funksion te zbatimit dhe permbushjes se kushteve te kontrates se koncesionit.

Neni 3

Kohezgjatja e Veprimtarise

Kohezgjatja e veprimtarise se Shoqerise eshte e pakufizuar.

Neni 4

Selia

4.1 Selia zyrtare e Shoqerise ndodhet ne adresen Tirane, Rruga 365 , Pll nr 8,kati 8 ,Apartamenti B Tirane.

4.2 Gjate ushtrimit te aktivitetit te saj, Shoqeria mund te hape dege dhe zyra perfaqesimi kudo ne territorin e Republikes se Shqiperise.

4.3 Adresa e Shoqerise per qellim te komunikimeve elektronike eshte vloraharborcm@gmail.com

Neni 5

Regjimi Juridik i Shoqerise

5.1 Kjo shoqeri mund te ndryshoje emertimin e saj, seline, te shtojë ortakët, te transferojë kuotat, te rrisë kapitalin etj.. ne perputhje me ligjin nr. 9901 date 14.04.2008 "Per tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar dhe kushtet e kontrates se koncesionit.

5.2 Shoqeria drejtohet sipas parimeve te ekonomise se tregut dhe ka qellime fitimi.

5.3 Veprimtaria e saj i nenshtrohet dispozitave te kontrates se koncesionit, legjislacionit tregtar e atij civil ne fuqi.

5.4 Shoqeria gezon personalitet juridik nga data e regjistrimit te saj ne Qendren Kombetare te Regjistrimit. Shoqeria ka vulen e saj .

5.5 Ne asnje rast aket e nxjerra apo/dhe veprimet e kryer nga shoqeria nuk duhet te bien ndesh me Kontraten e Koncesionit.

KREU II

Kapitali

Neni 6

Kapitali themeltar

6.1 Kapitali themeltar i shoqerise eshte 1,000,000 lek. Pjesemarrja e themeluesve ne kapitalin e shoqerise eshte ne perputhje me kontributet e tyre te meposhteme:

- Ortaku themelues " AGBES KONSTRUKSION" sh.p.k, zoteron një kuote ne vlerën prej 330,000 lekë shqiptare, që përbën 33% të kapitalit themeltar,

- Ortaku themelues "BESTA" sh.p.k zoteron një kuotë në vlerën prej 300,000 lekë shqiptare, që përbën 30% të kapitalit themeltar

- Ortaku themelues "Premium Construction & Maintenance" shpk zotëron një kuotë në vlerën prej 40, 000 lekë shqiptare, që përbën 4% të kapitalit themeltar

- Ortaku themelues "ITE. GRUP" shpk zotëron një kuotë në vlerën prej 80, 000 lekë shqiptare, që përbën 8% të kapitalit themeltar,

- Ortaku themelues "ARKONSTUDIO" shpk zotëron një kuotë në vlerën prej 250 000 lekë shqiptare, që përbën 25 % të kapitalit themeltar.

6.2 Kontributi i ortakeve eshte ne para.Derdhja dhe transferimi i kapitalit te rregjistruar do te behet nga administrator i shoqerise i emeruar ne kete satatut , nga llogaria likujduese e shoqerise Premium Construction and Maintanance shpk.

6.3 Ortaket jane pergjegjes kundrejt paleve te treta per humbjet qe peson Shoqeria, deri ne shumen e kontributit te tyre ne kapitalin themeltar te shoqerise.

6.4 Çdo kuote i jep zoteruesit te drejten e nje vote ne vleren e kuotes.

6.5 Kapitali themeltar mund te zmadhohet ose te zvogelohet me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, ne perputhje me dispozitat ligjore.

Neni 7

Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit


7.1 Kapitali themeltar mund te zmadhohet nepermjet nenshkrimeve te pjeseve te kapitalit themeltar dhe / ose çdo forme tjeter te parashikuar nga ligji.

7.2 Zvogelimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakeve, e cila merr vendim ne te njejtat kushte qe kerkohen per ndryshimin e statutit.

7.3 Ne te gjithë rastet, zvogelimi i prek ortaket ne te njejtën masë ndaj pjeseve te kapitalit qe perfaqesojne.

Neni 8

Transferimi i kuotave



8.1 Kuotat e kapitalit te shoqerise dhe te drejtat qe rrjedhin prej tyre, mund te fitohen apo kalohen nepermjet:

- a) kontributit ne kapitalin e shoqerise;
- b) shitblerjes;
- c) trashegimise;
- d) dhurimit;

e) çdo menyre tjeter te parashikuar me ligj.

8.2 Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme ndermjet ortakeve pa kerkuar me pare miratimin e ortakeve te tjere. E vetmja procedure qe mund te zgjedhin te ndjekin ortaket, ne rastin e transferimit te kapitalit ndermjet ortakeve, eshte nenshkrimi i kontrates noteriale perkatese (shitblerjes, dhurimit etj.).

8.3 Pervec sa parashikohet ne piken 8.2, transferimi i kuotave ne persona te trete te ndryshem nga Ortaket, venia peng, barre apo çdo mjet tjeter sigurimi mbi kuotat, do te kerkoje, ne menyre qe te prodhoje efekt, miratimin paraprak te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, e cila vendos me shumice te thjeshte.

8.4 Ne rastin kur nje Ortak ka per qellim te transferoje te gjithë apo nje pjese te kuotave te tij ne persona te trete te ndryshem nga Ortaket, ai, perpara se te nenshkruaje marreveshje me persona te trete, detyrohet te njoftoje me shkrim Administratorin per transferimin e planifikuar, duke percaktuar edhe çmimin e transferimit, personin/at te cileve planifikon t'u transferoje kuotat dhe kushtet esenciale te transferimit.

8.5 Administratori, brenda 10 diteve duke filluar nga dita qe ka marre dijeni per njoftimin per transferimin e planifikuar do te informoje me shkrim Ortaket e tjere.

8.6 Secili prej Ortakeve, brenda 1 (nje) muaji nga data e njoftimit nga Administratori per shitjen apo transferimin e planifikuar, detyrohet te njoftoje me shkrim Administratorin nese ka qellim te ushtroje te drejten e tij te parablerjes.

8.7 Administratori, brenda 10 (dhjete) diteve nga marrja e ketij njoftimi, do te njoftoje me shkrim Ortakun qe deshiron te transferoje kuotat e tij.

8.8 Nese me shume se nje Ortak ushtron te drejtat e parablerjes, ata do te fitojne keto kuota ne perpjestim me pjesemarrjen e tyre ne kohen e transferimit ne kapitalin themeltar.

8.9 Nese nje Ortak ka dhene njoftim per qellimin e tij per te ushtruar te drejten e parablerjes, ky Ortak do te kete te drejte te bleje kuotat objekt transferimi brenda 10 diteve nga data e mbarimit te afatit te percaktuar nga neni 8.6 me siper.

8.10 Vetem ne rast se te gjithë ortaket jane shprehur se nuk kerkojne te ushtrojne te drejten e parablerjes, atehere Ortaku qe ka per qellim te transferoje kuotat e tij do te jete i lire t'i transferoje keto kuota personit/ave te percaktuar ne njoftimin e tij.

8.11 Çdo transferim i kuotave qe nuk kryhet ne perputhje me parashikimet e ketij neni eshte i pavlefshem dhe pa efekte.

8.12 Transferimi i kuotave behet ne perputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara ne kontraten e koncesionit.

Neni 9

Regjistri i Ortakeve

9.1 Pronesia mbi kuotat do te regjistrohet ne regjistrin e ortakeve qe do te mbahet ne seline e Shoqerise nen pergjegjesine e Administratorit ("Regjistri i Ortakeve").



9.2 Regjistri i Ortakeve do te pasqyroje informacionin e meposhtem: (i) identitetin e cdo Ortaku; (ii) numrin dhe vleren e kuotave qe i perkasin cdo Ortaku; (iii) daten e fitimit te pronesise se secilit Ortak mbi kuotat; (iv) adresen apo seline e cdo Ortaku; (v) detaje per cdo peng apo barre te vendosur mbi kuotat.

KREU III

Organet vendimarrëse dhe drejtuese

Neni 10

Organet e Shoqerise

Organet e shoqerise jane:

- Asambleja e Ortakeve;
- Administratori.

Neni 11

Organi vendimarrës


11.1 Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimarrës i shoqerise e cila perfaqeson unanimitetin e Ortakeve.

11.2 Asambleja e Pergjithshme eshte organi i vetem vendimarrës i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj te cilat jane te detyrueshme per te gjithë ortaket e shoqerise edhe ne rastin se ata mungojne apo nuk shprehin voten e tyre pro apo kundra qe nga dita qe kane marre njoftimin sipas parashikimit ne statut.

11.3 Asambleja e Pergjithshme e ortakeve eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine, per çeshtjet e meposhtme:

- a) percaktimin e politikave tregtare te shoqerise;
- b) ndryshimin e statutit;
- c) emerimin e shkarkimin e administratoreve;
- ç) emerimin e shkarkimin e likujduesve dhe eksperteve kontabel te autorizuar;
- d) percaktimin e shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat "c" dhe "ç", te kesaj pike;
- dh) mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- e) zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit;
- f) pjestimin e kuotave dhe anullimin e tyre;
- g) perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe proçedimet e tera ndaj admnistratoreve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqerise;
- h) miratimin e rregullave proçeduriale te mbledhjeve te asamblese;
- i) çeshtje te tjera te parashikuara nga ligji nr. 9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" i ndryshuar apo statuti;

11.4 Ortaku mund te perfaqesohet ne asamblene e pergjithshme, ne baze te nje autorizimi nga nje ortak tjetër apo nga nje person i trete ne rastet e shoqerise me disa ortake; Autorizimi jepet ne forme shkresore perhere dhe eshte i vlefshem edhe per mbledhje te tjera me po kete rend dite nese nuk mbyllet po ate dite me vendimarrje.



11.5 Administratori i shoqerise nuk mund te veproje si perfaqesues i ortakeve ne asamblene e pergjithshme.

11.6 Autorizimi mund te jepet vetem per nje mbledhje te asamblese se pergjithshme, e cila perfshin edhe mbledhjet vijuese me te njetin rend dite.

11.7 Vendimet e Asambleja e Pergjithshme ne mbledhje te zakonshme te saj jane te vlefshme kur miratohen nga nje apo me shume ortake qe perfaqesojne shumicen e kapitalit themeltar.

11.8 Vendimet e Asambleja e Pergjithshme ne mbledhje te jashtezakonshme te saj jane te vlefshme vetem kur miratohen nga nje ose me shume ortake qe perfaqesojne te pakten 75% te kapitalit themeltar te shoqerise.

11.9 Asambleja e Pergjithshme miraton llogarite dhe bilancet e Shoqerise te komunikuar nga Administratori brenda gjashte muajve nga mbyllja e vitit financiare dhe vendos lidhur me ndarjen e fitimit ne formen e dividendit.

Neni 12

Mbledhja e Asamblese se Pergjithshme dhe thirrja e saj

12.1 Asambleja e Pergjithshme mblidhet sa here qe mbledhja eshte e nevojshme per te mbrojtur interesat e shoqerise.

12.2 Mbledhja e Asamblese se Pergjithshme thirret te pakten nje here ne vit.

12.3 Asambleja e Pergjithshme thirret nga administratoret apo ortaket te cilet perfaqesojne te pakten 10% te totalit te votave ne asamblene e pergjithshme te shoqerise.

12.4 Asambleja e Pergjithshme thirret nepermjet njoftimit me shkrese te derguar ne adresen postare te ortakeve ose nepermje postes elektronike si dhe nepermjet çdomjeti komunikimi elektronik i cili provon dergimin e njoftimit.

12.5 Njoftimi me shkrese apo nepermjet nje prej formave elektronike duhet te permbaje vendin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e dites e t'u dergohet te gjithë ortakeve, jo me vone se 7 dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese.

12.6 Kur Asambleja e Pergjithshme nuk eshte thirrur si me siper, ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese te gjithë ortaket jane dakord, per te marre vendime, pavaresisht parregullsive.

Neni 13

Korumi i nevojshem dhe vendim-marrja

13.1 Ne rastin e marrjes se vendimeve, qe kerkojne nje shumice te zakonshme, asambleja e pergjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortaket me te drejte vote, qe zoterojne me shume se 30 % te kuotave.

13.2 Ne rastin kur asambleja e pergjithshme duhet te vendose per ceshtje, te cilat kerkojne shumice te kualifikuar, ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese ortaket qe zoterojne me shume se gjysmen e numrit total te votave jane te pranishem personalisht, votojne me shkrese, apo mjete elektronike.

13.3 Nese asambleja e pergjithshme nuk mund te mblidhet per shkak te mungeses se korumit te permendur me siper, asambleja mblidhet perseri jo me vone se 30 dite, me te njejtin rend dite.

13.4 Asambleja e pergjithshme vendos me tre te katertat e votave te ortakeve pjesemarres, per ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te regjistruar, shperndarjen e fitimeve dhe prishjen e shoqerise.

13.5 Per çeshtjet e tjera, asambleja e pergjithshme vendos me shumicen e votave te ortakeve pjesemarres.

13.6 Ortakët, që nuk janë të pranishëm, kane mundësinë e pjesëmarrjes në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme me mjete të ndryshme komunikimi

Mjetet elektronike përfshijnë, por pa u kufizuar në to:

- a) transmetimin e mbledhjes së asamblesë së përgjithshme në kohë reale;
- b) komunikimin e ndërsjellë në kohë reale, i cili u mundëson ortakëve të shprehen për mbledhjen e asamblesë së përgjithshme nga një vendndodhje tjetër;
- c) mekanizma, që mundësojnë procesin e votimit, përpara apo gjatë mbajtjes së mbledhjes së asamblesë së përgjithshme, pa qenë nevoja të caktohet një përfaqësues i autorizuar, për të marrë pjesë fizikisht në mbledhje.

Neni 14

Përrjashtimi nga e drejta e votës

14.1 Ortaku nuk mund të ushtroj të drejtën e votës nëse Asambleja e Përgjithshme merr vendimin për:

- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- ç) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

14.2 Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

Neni 15

Procesverbali i mbledhjes së asamblese

15.1 Te gjitha vendimet e Asamblese së Përgjithshme duhet të regjistrohen në procesverbal.

15.2 Administratori përgjigjet për ruajtjen e kopjeve të procesverbaleve të mbledhjeve të asamblese së përgjithshme.

15.3 Procesverbali duhet të përmbajë datën e vendin e mbledhjes, rendin e dities, emrin e mbajtesit të procesverbalit dhe rezultatet e votimit. Procesverbalit i bashkelidhet edhe lista e pjesëmarrësve, si, akti i thirrjes së asamblese së përgjithshme dhe njoftimet dhe letermarrjet/konfirmimet e ortakëve.

15.4 Procesverbali i mbledhjes nënshkruhet nga anëtarët pjesëmarrës dhe nga mbajtesi i procesverbalit.


Neni 16

Administrimi

16.1 Asambleja e Përgjithshme emeron administrator të shoqërisë z HEKTOR AGALLIU, atësia Nuri, amësia Zyrako, shtetas Shqiptar, lindur në Tërpan, Berat dhe banues në Dimal, me adresë Engjëll Agalliu; Nd. 037; H. 0; Ap. 0; Ura Vajguore; 5007; Dimal, lindur më 27/01/1957, Identifikuar nga letërnjoftimi me nr personal F70127128J

16.2 Afati i emerimit është 5 vjet, me të drejtë riemerimi.

16.3 Në rast se gjatë kësaj periudhe shfaqen probleme paaftësie nga ana e tij, Asambleja e Përgjithshme vendos shkarkimin e administratorit duke treguar me fakte demin që i është



shkaktuar shoqerise nga paaftesia e tij pasi eshte dhene mendimi per kete dem edhe nga specialistet perkates.

16.4 Emerimi i administratorit prodhon efekte pas regjistrimit ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.

16.5 Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë osë ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

16.6 Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga Asambleja e Përgjithshme, që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

16.7 Kompetencat dhe përgjegjesite e administratorit jane:

a) ka liri te plote dhe te pakufizuar per drejtimin e zakonshem te shoqerise, ka te gjitha kompetencat per te vepruar me te tretet ne emer te shoqerise dhe ne interes te saj, ne te gjitha rrethanat, me perjashtim te kompetencave qe ligji nr. 9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" i ndryshuar dhe Statuti i shoqerise, si me siper, ua jep shprehimisht ortakeve.

b) ka te drejte te nenshkruaje kontrata te ndryshme sherbimi, porosie, furnizime publike private si dhe çdo kontrate tjeter te nevojshme qe ka per qellim dhe eshte ne funksion te realizimit te te drejtave dhe detyrimeve qe rrjedhin nga Kontrata e Koncesionit.

c) Administratori ka te drejte te nenshkruaje kontrata me studio ligjore, te ndermarre veprime gjyqesore ne emer dhe per llogari te shoqerise, etj. Administratori mund te jape prokura ne kufijte qe i lejon Asambleja e Ortakeve per kategori te caktuara veprimesh. Perfaqesimi ligjor i shoqerise eshte i vlefshem per cdo veprim gjyqesor apo jashtegjyqesor.

d) Administratori eshte i detyruar te mbaje konform ligjit te gjitha regjistrat e domosdoshme per aktivitetin e shoqerise. Administratori i shoqerise eshte i detyruar te mbaje inventare te rregullta. Raporti i administrimit, inventari dhe llogaritë vjetore, hartohen nga Administratori.

e) Administratori, gjate kryerjes se detyrave te tij, pergjigjet ndaj shoqerise per cdo veprim apo mosveprim qe lidhet ne menyre te arsyeshme me qellimet e shoqerise tregtare, me parjashtim te rasteve kur ne baze te hetimit dhe vleresimit te informacioneve perkatese veprimi apo mosveprimi eshte kryer ne mirebesim.

f) Administratori eshte përgjegjës për administrimin e shoqerise dhe informon periodikisht ortakët për ecurinë e veprimtarisë tregtare të shoqerise. Gjate veprimtarise se tij ai vepron duke marre parasysh interesat e shoqerise, duke zbatuar parimet e detyrimit te besnikerise.

g) te tjera te parashikuara me ligjin nr. 9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" i ndryshuar.

Neni 17


Konfidencialiteti

Veprimtaria e shoqerise dhe marrëdhëniet e punes me punonjesit e saj bazohen ne respektimin e detyrimit te ruajtjes se konfidencialitetit.

Neni 18

Të drejtat e lidhura me kuotën

Ortaku, që pengohet të ushtrojë të drejtat që i rrjedhin nga zotërimi i kuotës së shoqërisë, ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës të urdhërojë ndalimin e cenimit apo shpërblimin e dëmit të shkaktuar, si pasojë e cenimit të këtyre të drejtave. Kjo e drejtë parashkruhet brenda 3 vjetëve nga çasti i cenimit.



KREU IV

VITI FINANCIAR – EKSPERTËT

Neni 19

Viti financiar dhe dividenti

Viti financiar i shoqërisë fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor. Përgjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe mbyllet më 31 Dhjetor.

Neni 20

Ekspertet

20.1 Kontrolli mbi veprimtarinë e Administratorit si dhe mbi gjithë aktivitetin e shoqërisë i besohet një eksperti kontabel i cili emrohet nga Asambleja e Përgjithshme. Kohezgjatja e veprimtarisë së ekspertit dhe shperblimi caktohen me vendim të Asamblese së Përgjithshme.

20.2 Eksperti, në fund të periudhës së kontrollit, harton raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar dhe detyrohet t'ua dorëzojë të gjithë ortakeve.

Neni 21

Bilanci dhe dividenti

Veprimtaria ekonomike e shoqërisë do të mbyllet në dt. 31 Dhjetor të çdo viti. Administratori merr masë për hartimin e bilancit dhe rezultatit ekonomik fitim - humbje dhe inventar. Pasi vecohen fondet si me sipër dhe paguhen detyrimet fiskale, të ardhurat që mbeten ndahen midis ortakeve dhe mund të transferohen lirisht jashtë Republikës së Shqipërisë sipas dispozitave përkatëse ligjore.

Neni 22

Shpërndarja dhe likuidimi i Shoqërisë

22.1 Shoqëria prishet:

- (i) me vendim të Asamblese së Përgjithshme të Ortakeve; ose
- (ii) në rast falimentimi; ose
- (iii) kur Shoqëria nuk ka kryer veprimtari për 2 (dy) vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në QKR; ose
- (iv) me vendim gjykatës; ose
- (v) për arsye të tjera të parashikuara në ligj.

22.2 Prishja e shoqërisë regjistrohet në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit nga Administratori.

22.3 Prishja e shoqërive tregtare ka si pasoje hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedure falimentimi. Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga asambleja e përgjithshme. Nëse asambleja e përgjithshme nuk merr një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

22.4 Çdo person i interesuar, ka te drejte t'i kerkoje gjykates zevendesimin e likuiduesit, sipas vendimit te ortakeve, nese paraqet arsye te mjaftueshme per te dyshuar se likuidimi i rregullt i shoqerise mund te cenohet nga likuiduesit e emeruar si me siper. Kerkesa duhet te depozitohet ne gjykate brenda 30 diteve nga data e caktimit te likuiduesit.

22.5 Gjykata emerom likuiduesin, ne rastet kur shoqeria tregtare priset me vendim gjykate. Likuiduesit shkarkohen dhe zevendesohen me te njejtat kushte, te parashikuara ne dispozitat per emerimin e tyre.

22.6 Administratoret e shoqerise i njoftojne per regjistrim, Qendres Kombetare te Regjistrimit te dhenat e likuiduesve te pare dhe tagrat e tyre, per te perfaqesuar shoqerine, se bashku me dokumentet perkatese. Likuiduesit depozitojne nenshkrimin e tyre.

22.7 Likuiduesit i njoftojne, gjithashtu, Qendres Kombetare te Regjistrimit per regjistrim gdo ndryshim per identitetin dhe tagrat e tyre te perfaqesimit.

22.8 Likuiduesit duhet te ftojne kreditorët e shoqerise per te depozituar pretendimet e tyre per prishjen e saj. Likuiduesi merr persiper te drejtat dhe detyrimet e administratoreve nga data e emerimit te tij.

Neni 23

Librat e shoqerise

Shoqeria ne baze te ligjit mban:

- 1) Librin e Ortakeve
- 2) Librin e Mbledhjeve
- 3) Librin e vendimeve te organit administrativ
- 4) Librin e mbledhjeve dhe vendimeve te eksperteve.

Librat e mesiperm duhet te jene te ruajtura per 10 vjet e cdo faqe duhet te jete e vulosur.

Neni 24

Riorganizimi i shoqërisë, bashkimi, ndarja

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas vendimit të Mbledhjes të Asamblesë së Pergjithshme, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në pjesën e IX të Ligjit 9901 date 14.04.2012 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".


Neni 25

Norma referuese

25.1 Persa nuk parashikohet ne kete statut do te behet referimi ne ligjet e miratuara dhe ato ne fuqi ne republiken e Shqiperise ne fushen e shoqerive tregtare.

25.2 Autoritetet Gjyqesore Shqiptare jane ato te cilat kane kompetencen ekskluzive per zgjidhjen e te gjitha mosmarreveshjeve qe mund te lindin midis ortakve apo midis tyre dhe Organeve te shoqerise.

Neni 26



Dispozita te pergjithshme

Persa eshte shprehur ne kete statut i referohemi Ligjit nr. 9901 dt 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" i ndryshuar dhe Kontrates se Koncesionit.

Cdo ndryshim behet ne te njejten menyre sic eshte nxjerre ky Statut dhe nuk prek personalitetin juridik te kesaj shoqerie.

Ky Statut hyn ne fuqi pas miratimit dhe regjistrimit te Shoqerise ne regjistrin tregtar prane Qendres Kombetare te Regjistrimit.

Gjithcka nuk eshte parashikuar shprehimisht ne kete Statut do te rregullohet nga legjislacioni tregtar dhe ligje te tjera te lidhura me te ne fuqi ne Republiken e Shqiperise.

Ky Statut perpilohet ne 5 (pese) kopje ne gjuhen shqip dhe anglisht me te njejten vlere, dhe nenshkruhet pa verezjte nga ortaket themelues.

ORTAKET E SHOQERISE

"VLORA HARBOR CONSTRUCTION AND MAINTANANCE SHPK"

Shoqëria "AGBES KONSTRUKSION" sh.p.k

përfaqësuar nga Administratori
z.Arben Goga

Shoqëria "BESTA" sh.p.k

përfaqësuar nga nga Administratori
Znj. Drita Azizi,

Shoqëria "Premium Construction & Maintenance" sh.p.k

përfaqësuar nga nga Administratori
z. Hektor Agalliu

Shoqëria "ITE. GRUP" sh.p.k

përfaqësuar nga administratori
z Sokol Zotkaj ,

Shoqëria "ARKONSTUDIO" sh.p.k

përfaqësuar nga nga Administratori
z Nasjel Cico